




KOMUNA SHITIME



AMJ

Nr. prot: 02/394
21/04/2026

Tree-Planting-Shtime/2026

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

lidhur ndërmjet

KOMUNËS SË SHITIMES

dhe

AMJ

Për mbjelljen e **30 (tridhjetë) fidanëve** dhe **30 (tridhjetë) fotinjave** në Komunën e Shtimes, në vigjilje të Ditës Ndërkombëtare të Tokës.

Shtime, 21.04.2026

QËLLIMI

Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Shtimes dhe AMJ është mbjellja e **30 fidanëve** dhe **30 fotinjave**. Kjo përkon me Ditën e Tokës më 22 prill, dhe është një mundësi e shkëlqyer për të ndihmuar në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit. Mbjellja e fidanëve ka një rëndësi të veçantë, pasi fidanët janë pemë që kontribuojnë shumë në pastrimin e ajrit dhe ruajtjen e biodiversitetit. Ato mbajnë balancën e klimës, duke absorbuar dioksidin e karbonit dhe duke ofruar oksigjen të pastër për ne. Gjithashtu, ato ndihmojnë në parandalimin e erozionit të tokës dhe mbështesin jetesën e shumëllojshme të faunës. Aktivitetet e tilla, si mbjellja e fidanëve, jo vetëm që kontribuojnë në pasurimin e peizazhit, por gjithashtu i ndihmojnë komunitetet të ndërgjegjësohen për rëndësinë e mbrojtjes së natyrës. Mbjellja e fidanëve është një hap i vogël, por i rëndësishëm, që na ndihmon të krijojmë një të ardhme më të pastër dhe të qëndrueshme për brezat që do të vijnë. Aktivitetet si ky, që do të realizohet në katër komuna të Kosovës, janë një hap i madh për t'u bashkuar dhe për të vepruar për një botë më të shëndetshme.

ORGANIZIMI I MBJELLJES SË FIDANËVE DHE I FOTINJAVE

Mbjellja e fidanëve do të bëhet nga kompania "Natyra.Garden", e kontraktuar nga AMJ.

LLOJI I FIDANIT DHE I FOTINJAVE

Fidanët që do të mbillen janë të gjatë 2 deri 3 metra (si në foto **majtas**). Ndërsa fotinjat do të jetë rreth 1.50 metër (si në foto **djathtas**).



PËRGJEGJËSITË E KOMUNËS SË SHITES:

1. Komuna e Shtimes përcakton lokacionin ku do të mbillen fillimisht 30 fotinja dhe 26 fidanë, dhe më pas edhe 4 fidanë të tjerë në ditën e përfundimit të projektit;
2. Të jenë të përpiktë në respektim të orarit dhe datës së caktuar të zhvillimit të projektit;
3. Angazhon së paku një mbikëqyrës komunal gjatë mbjelljes së fidanëve.
4. Organizon një program simbolik në ditën e përfundimit të projektit në mes të muajit maj 2026, ku do të marrin pjesë zyrtarë e përfaqësues të AMJ nga Evropa.

PËRGJEGJËSITË E AMJ:

1. Përmes kompanisë së kontraktuar, obligohet që të fillojë mbjelljen e 30 fotinjave dhe 26 fidanëve në lokacionin e përcaktuar nga Komuna e Shtimes;

2. Përmes një vullnetari të saj, obligohet që të mbikëqyrë mbarëvajtjen e mbjelljes së fidanëve;

3. Përmes një programi simbolik, do të përfundojë mbjelljen edhe të 4 fidanëve të fundit në praninë e përfaqësuesve komunalë dhe përfaqësuesve vendor e ndërkombëtar të AMJ, që shënon edhe përfundimin e projektit.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Ky memorandum është nënshkruar në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

HYRJA NË FUQI

Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët, dhe zbatimi i saj fillon më datë: _____.

Vendi: Shtime

Data: _____

Komuna e Shtimes
Për *Adriana Fidan*
(vula dhe nënshkrimi)



AMJ

(vula dhe nënshkrimi)